

Përgjigja ndaj pyetjes së deputetes Gjylnaze Syla (nr. 03/0711/Do-397, datë 11.06.2008):

A ka MTI strategji të investimeve?

Përgjigja:

I nderuari z. Kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Syla,

Më lejoni që së pari të cek se pyetja e juaj nuk përcakton në mënyrë specifike se për çfarë strategjie konkretisht e keni fjalën:

- për strategjinë e promovimit të investimeve të huaja në Kosovë, apo
- për strategji të rritjes së investimeve në konsumin e përgjithshëm shoqëror.

Unë do të mundohem të përgjigjem shkurt mbi strategjinë për promovimin e investimeve të huaja në Kosovë, duke pasur parasysh se në kuadër të MTI-së funksionon Agjencia për promovimin e investimeve, kurse çështja e rritjes së konsumit investiv është çështje më komplekse dhe do të duhej të trajtohej në nivel ndërministror.

Përgjigja sa i përket strategjisë për promovimin e investimeve të huaja është negative që d.m.th se Kosova nuk e ka këtë strategji të hartuar si dokument zyrtar dhe të aprovuar nga MTI-ja gjegjësisht Qeveria. Besoj se pajtoheni që kjo nuk mundet të kryhet për një kohë kaq të shkurtë sa unë jam në krye të MTI-së.

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e pakontestueshme të investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të vendit, elementet kryesore të strategjisë së ardhshme janë të përfshira në programin e qeverisë dhe të detajizuara në planin e punës së MTI-së për vitin 2008, në Kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH 2009-2011), në Strategjinë e zhvillimit të sektorit privat, në Planin aksional të veprimit për partneritetin evropian, ku vërehen qartë aktivitetet për krijimin e ambientit më të mirë për biznes dhe tërheqjes së investimeve të huaja direkte në Kosovë.

Me këtë rast unë do të përmend vetëm disa nga aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe afër gjashtë-mujore:

- Organizimi i takimeve me investitorë nga vende të caktuara me qëllim të informimit mbi potencialet investive në Kosovë (Austria dhe Suedia);
- Promovimi i investimeve në Kosovë në disa konferenca ndërkombëtare (Forumi i Crans Montana-s në Tiranë, Konferenca mbi mundësitë e investimeve në Kosovë, e organizuar bashkë me Odën Ekonomike Amerikane në Lubjanë, Samiti për biznes dhe investime, i mbajtur javën e kaluar në Prishtinë, etj.);
- Panairi ndërkombëtar i industrisë në Prishtinë, i bashkë-organizuar me Odën Ekonomike të Kosovës;
- Punimi i dy analizave sektoriale të investimeve, ajo për industrinë e drurit dhe industrinë e përpunimit të metaleve;
- Përgatitja dhe ofrimi i materialeve të reja promovuese për mundësinë e investimeve në Kosovë, në përfundim është guida e re për investitorë 2008;
- Marrja pjesë aktive dhe dhënia e rekomandimeve në komisionin për reformimin e politikave fiskale.
- Angazhimi aktiv në komisionin për luftën kundër ekonomisë informale;
- Krijimi i grupit të ekspertëve për shqyrtimin e eliminimit të të gjitha atyre licencave që nuk janë të domosdoshme për bizneset, për të krijuar një liri dhe mundësi më të madhe veprimi pa procedura burokratike;
- Aprovimi i Strategjisë së zhvillimit të sektorit privat 2008 - 2010; si dhe
- Miratimi i strukturës së re organizative funksionale të Agjencisë për promovim të investimeve bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare;

Prishtinë, 30 qershor 2008